# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6082
E shtunë, 8 gusht 2020
çmimi 0.40 €


## I jepet lamtumira babait të kryeredaktorit të 'Epokës së re', Isa Qorrajt

FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", MUHARREM NITAJ FAQE 4-5

# INSISTOJMË NË LIDERSHIPIN E SHBA-SË NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI



Nënkryetari i AAK-së, Muharrem Nitaj, ka bërë me dije se kjo parti insiston jo vetëm në përfshirjen, por edhe në lidershipin e ShBA-së në dialogun Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se kritikat e tyre për këtë proces edhe në mënyrë të shkruar ia kanë paraqitur kryeministrit Avdullah Hoti. Ai ka deklaruar se ky proces duhet të jetë krejtësisht transparent dhe në çdo rrethanë pjesë e procesit duhet të jenë edhe përfaqësuesit e Aleancës. Sipas Nitajt, kritikat e kësaj partie për procesin e dialogut nuk duhet të shihen si konflikte ndërmjet partnerëve të koalicionit

# FSK-ja SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E USHTARËVE TË RINJ



Nga 10 gushti do të shpallet konkursi për pranimin e rekrutëve të rinj/ushtarë aktivë në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Formularët për aplikim mund të shkarkohen në uebfaqen e Ministrisë së Mbrojtjes. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka ftuar të rinjtë e Kosovës që të aplikojnë dhe të bëhen pjesë e ushtrisë për t'i shërbyer vendit FAQE 4

## KUVENDI MIRATON NË LEXIM TË PARË PROJEKTLIGJIN KUNDËR COVID-19 FAQE 7




## OPINION

### FONDI "VENDLINDJA THËRRET", VLERË QË ËSHTË SHTRIRË NË SHBA DHE NË TË GJITHA VENDET E TJERA TË BOTËS KU KA SHQIPTARË (26)

F. 11



Shkruan:
Kudusi LAMA

## AKTUALE

### TRE TË VDEKUR, 125 TË SHËRUAR DHE 181 RASTE TË REJA ME VIRUSIN KORONA F. 7

### AGK-ja DHE SHSK-ja NDAJNË MASKA DHE DEZINFEKTUES PËR GAZETARË F. 5

## EKONOMI



### QEVERIA NDAN 95.2 MILIONË PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE

F. 9

### MURTEZAJ: QARKULLIMI FINANCIAR I BIZNESEVE KA RËNË PËR 833 MILIONË EURO, SHKAK PANDEMIA F. 9

### HOTI: QEVERIA DO TA MBËSHTESË TELEKOMIN E KOSOVËS F. 9


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
KOLEGJI BIZNESI · BIZNESI COLLEGE · PRISHTINË 2004
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# DASh-i, thirrje amerikanëve: Mos udhëtoni drejt Kosovës, rrezik nga virusi dhe sulmet terroriste

**Prishtinë, 7 korrik** - Departamenti Amerikan i Shtetit u ka bërë thirrje qytetarëve amerikanë që të mos marrin rrugë drejt Kosovës për shkak të Covid-19. Përveç kësaj, në thirrjen e bërë theksohet edhe shtimi i kujdesit për shkak të terrorizmit. "Në disa zona ka shtim të rrezikut", thuhet në apelin e Departamenti Amerikan të Shtetit.

Qendra për Kontroll dhe Parandalim të Sëmundjeve ka lëshuar paraprakisht një njoftim të Nivelit të 3 të shëndetit për Kosovën për shkak të koronavirusit, ndërkaq më vonë e ka ngritur atë në nivelin 4. "Ata që udhëtojnë në Kosovë mund ta përjetojnë mbyllje të kufijve, mbyllje në aeroporteve, pengesa të udhëtimit, qëndrim në shtëpi, mbyllje biznesesh dhe situata të tjera emergjente për shkak të Covid-19", është thënë në apelin Departamenti Amerikan të Shtetit, duke i ftuar qytetarët amerikan që t'i rishqyrtojnë udhëtimet drejt Mitrovicës së Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçanit për shkak të trazirave civile.

"Grupe terroriste mund të vazhdojnë të planifikojnë sulme terroriste në rajonin e Ballkanit, përfshirë Kosovën. Terroristët mund të sulmojnë pa paralajmërim, duke vënë në shënjestër lokacione turistike, stacione autobusësh, qendra tregtare dhe dyqane, institucione lokale, hotele, klube, restorante, vendpunishte, parqe, qendra sportive dhe kulturore, institucioneve edukative, aeroporte dhe zona publike. Për më të tepër, në Kosovë mund të ketë edhe dhunë të motivuar politikisht".

Apeli i Departamentit Amerikan të Shtetit përmban edhe disa




rekomandime.

"Nëse vendosni për të udhëtuar drejt Kosovës: Shihni uebfaqen e Ambasadës së ShBA-së lidhur me Covid-19; vizitoni uebfaqen e Qendrës së Kontrollit dhe Parandalimit të Sëmundjeve; shmangi demonstratat; qëndroni vigjilentë në lokacionet e frekuentuara nga perëndimorët; monitoroni mediat lokale për ngjarjet e fundit dhe përshtatni planet në bazë të informacioneve të reja; qasuni në 'Smart Traveler Enrollment Program (STEP)' për t'i pranuar njoftimet në mënyrë që të lokalizoheni më lehtë në situatë emergjente; përcillni Departamentin e Shtetit në 'Facebook' dhe 'Twitter'; rishikoni raportin për krime dhe siguri në Kosovë; përgatituni për situata emergjente, rishikoni 'Traveler's Checklist'", është thënë në apelin e DASh-t.

# Mungesa e gjakut, alarmuese

**Prishtinë, 7 gusht** - Edona, 40-vjeçare nga Prishtina, për pesë vjet me radhë, dy deri në tri herë në vit dhuron gjak për të shpëtuar jetë. Ajo thotë se këtë veprim e bën edhe për veten që të ndihet mirë. Por, qëkur ka filluar pandemia nuk ka shkuar më në Qendrën e Transfuzionit të Gjakut në Prishtinë. "Fatkeqësisht jo, nga frika prej pandemisë. Këtë vitin e fundit, prej janarit, nuk kam dhënë asnjëherë. Në shkurt e kam pasur kohën, por nuk kam mundur të shkoj, pastaj filloi pandemia dhe prej marsit u mbyllën krejt. Por, edhe frika nga pandemia", ka thënë ajo.

Aktualisht Qendra e Transfuzionit të Gjakut është në gjendje alarmi. Mungesa e vullnetarëve të gjakut ka bërë që tashmë të harxhohen rezervat e grumbulluara. Në Kosovë, përmes vullnetarëve, sigurohen rreth 30 mijë doza gjak në vit. Me këto doza sigurohen rreth 90 për qind të nevojave të pacientëve për gjak, në institucione publike shëndetësore në Kosovë. Kështu ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", Bukurije Zhubi, drejtoreshë e Transfuzionit të Gjakut, sipas së cilës, përpos personave me Covid-19, e që kanë pasur nevojë për gjak, shumë pacientë të tjerë të aksidentuar e me sëmundje të tjera, i kanë shpenzuar dozat e gjakut. "Ne kemi pasur një rezervë të madhe të gjakut, të cilën e kemi grumbulluar gjatë muajit qershor kur e kemi pasur javën e dhurimit vullnetar të gjakut. Ato rezerva deri tash kanë qenë të mjaftueshme, por meqenëse numri i të sëmurëve me Covid-19 u rrit dukshëm, i kemi ndërprerë aksionet e dhurimit vullnetar të gjakut", ka thënë Zhubi.

Muaji i fundit kur është grumbulluar gjak, ka qenë qershori i këtij viti. Ndërsa nga ai muaj e deri këtë javë kur edhe është bërë thirrje te qytetarët që të dhurojnë gjak, nuk është grumbulluar rezervë.

Zhubi ka thënë se edhe të sëmurët me Covid-19 po kanë nevojë për gjak, andaj kjo edhe ka ngritur alarmin tek institucionet që të sigurojnë doza gjaku. "Apelojmë te të gjithë qytetarët e Kosovës që të dhurojnë gjak, pasi dhurimi në këtë kohë e bën atë person dyfish hero. Gjak marrin edhe pacientët me Covid-19. Mund të them që deri tash 70 pacientë me Covid-19 pozitivë kanë marrë gjak", tregon Zhubi.


Bujar Tërstena (RFE/RL)

Edhe Shpresa Bucolli, 39-vjeçare, nga Prishtina, juriste me profesion, është dhuruese e rregullt e gjakut. Sipas saj, dhurimi i gjakut duhet të bëhet obligim moral dhe njerëzor për të gjithë. Ajo edhe gjatë kohës së pandemisë nuk e ka ndërprerë dhurimin vullnetar. Herën e fundit ka dhuruar në muajin qershor kur edhe ishte organizuar nga Qendra e Transfuzionit. "Unë kam dhënë në muajin qershor, atëherë kur edhe e kam pasur kohën. Unë jap gjak çdo katër muaj. Nuk jam frikësuar nga Covid-19 sepse ndihem e sigurt gjatë dhurimit të gjakut. Unë që nga shkolla e mesme dhuroj vullnetarisht gjak", ka thënë Bucolli.

Bazuar në të dhënat e Transfuzionit të Gjakut, numri i dhuruesve të gjakut në Kosovë është rritur nga viti në vit. Dhuruesit e gjakut janë të moshave të ndryshme dhe grupeve të ndryshme të gjakut.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Kuvendi miraton në lexim të parë Projektligjin kundër Covid-19

Me 77 vota për, një kundër dhe një abstenim, deputetët e Kuvendit e kanë miratuar në lexim të parë Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, i cili është iniciuar nga kryeparlamentarja Vjosa Osmani. Këtij projektligji i kanë dhënë mbështetje edhe dy subjektet politike opozitare, LV-ja dhe PDK-ja



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Kuvendi i Kosovës ka miratuar të premten në lexim të parë Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, i cili është propozuar nga gjashtë deputetë, në krye me kryetaren e Kuvendit, Vjosa Osmani. Në favor të këtij projektligji kanë votuar 77 deputetë, një ka qenë kundër dhe një tjetër ka abstenuar. Gjatë seancës është përkrahur edhe propozimi i Komisionit të Shëndetësisë që leximi i dytë i këtij ligji të bëhet të premten e javës së ardhshme.

Kryeparlamentarja Vjosa Osmani, si propozuese e projektligjit, ka thënë se ky dokument ka për qëllim ta mbrojë shëndetin e qytetarëve në Kosovë dhe që, siç ka thënë ajo, autoritetet përkatëse t'i ndërmarrin masat e duhura në parandalimin e sëmundjes, Covid-19, që shkakton koronavirusi, në përputhje edhe me ligjet e tjera dhe Kushtetutën e Kosovës. "Nëpërmjet këtij ligji presim që të krijohet edhe mundësia e shqiptimit të sanksioneve për personat fizikë dhe juridikë, të cilët nuk zbatojnë masat e vendosura nga ana e qeverisë. Nëpërmjet këtij ligji parashohim ndëshkime, në veçanti për ata persona që pozitën apo ndikimin e tyre në shoqëri e keqpërdorin për të shpërndarë dezinformata se nuk ka virus", ka thënë Osmani.

Ajo ka ftuar deputetët që ta votojnë projektligjin në leximin e parë duke thënë se ligji nuk është vetëm i deputetëve propozues, por i të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. "Për arsye të ndryshme ky ligj është zvarritur nga marsi, përkundër faktit që ka qenë kërkesë e qartë e Gjykatës Kushtetuese dhe pastaj, që nga prilli, kur edhe zyrtarisht është vendosur të procedohet kjo nismë. Deri tani ligji ka mbetur peng i politikave, por shpresoj që tash japim shembull se e vendosim shëndetin para politikave", është shprehur ajo.

Ndërsa kryetarja e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Albena Reshitaj, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka thënë se ky projektligj duhet të përkrahet, por atij duhet t'i shtohet edhe neni për përkrahjen e personelit shëndetësor.

Në draft-ligjin e hartuar tashmë, i cili ka vetëm tetë nene, thuhet se "ligji ka për qëllim që ta krijojë hapësirën e domosdoshme juridike për autoritetet me qëllim të luftimit dhe parandalimit të pandemisë".

Këtij projektligji i kanë dhënë mbështetje edhe dy subjektet opozitare, LV-ja dhe PDK-ja.

Nënkryetarja e Kuvendit nga radhët e LV-së, Arbërie Nagavci, ka kërkuar nga deputetët që ta mbështesin projektligjin në fjalë. "Ky projektligj u iniciua në prill - më shumë se 3 muaj më parë, por qeveria Hoti nuk e miratoi të njëjtin me procedurë të rregullt. Për fat të keq të qytetarëve, vijuan masat e çorganizuara. Fatkeqësisht, betejën me virusin e kanë humbur më shumë 300 qytetarë", ka deklaruar ajo, duke shtuar se qeveria ka tentuar ta pengojë miratimin e këtij projektligji. "Që tre muaj ky projektligj pengohej nga kjo qeveri që, si e tillë, e vlerësoi si nismë të panevojshme. Sot situata është tërësisht jashtë kontrollit, qytetarët me të drejtë ndihen të shqetësuar", është shprehur ajo.

Edhe Bekim Haxhiu nga Partia Demokratike e Kosovës ka thënë se do ta mbështesin projektligjin për parandalimin dhe luftimin e Covid-19. Sipas tij, është i nevojshëm miratimi i këtij projektligji. Në Kosovë aktualisht lidhur me situatën e pandemisë veprohet në bazë të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse. Edhe dënimet në rast të mosrespektimit të vendimeve bazohen po në këtë ligj. Në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse nuk ka qenë e paraparë pandemia si Covid-19, rrjedhimisht disa deputetë të Kuvendit të Kosovës, por edhe juristët kanë kërkuar miratimin e një ligji të ri, i cili do të ishte më i përshtatshëm për rrethanat e krijuar me pandeminë.

## Nuk miratohet Projektligji për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së, shkak mungesa e kuorumit

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk e kanë miratuar Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së i cili është propozuar nga grupi parlamentar i PDK-së për shkak të mungesës së kuorumit.

Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka bërë me dije se ky projektligj do të hedhet në votim të enjten e javës së ardhshme. Gjatë diskutimeve rreth Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së është zhvilluar një debat i ashpër në mes të pozitës dhe opozitës.

Kujtojmë se ky projektligj është kundërshtuar nga ambasadori i ShBA-së, Philip Kosnett, ai i Gjermanisë, Jörn Rohde, dhe Zyra e BE-së në Kosovë.

# I jepet lamtumira babait të kryeredaktorit të 'Epokës së re', Isa Qorrajt

DEÇAN, 7 GUSHT - Të premten në Carrabreg të Poshtëm të Komunës së Deçanit i është dhënë lamtumira e fundit babait të kryeredaktorit të gazetës "Epoka e re", Mal Qorrajt, Isa Qorraj.





Isa Qorraj në moshën 59-vjeçare ka ndërruar jetë të enjten në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, në të cilën po trajtohej që prej aksidentit të ndodhur një javë më parë.

Me rastin e vdekjes së bacës Isë, telegram ngushëllimi familjes Qorraj i ka dërguar botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, i cili familjes Qorraj i ka shprehur ngushëllime për humbjen e familjarit. "Veçanërisht, ngushëllime kryeredaktorit të 'Epokës së re', Mal Qorrajt, Ardianës dhe Arturit për humbjen e babait! Bashkëndiejmë dhe jemi me Ju! Isa Qorraj ka mundur t'i bishtnojë vajtjes në punë për shkak të vendimit qeveritar, por donte pagën me nder. Një djalosh i ri, pa leje të vozitjes, me shpejtësi të lartë e goditi për fatalitet teksa ky kthehej nga puna!", ka shkruar Mavraj në telegram-ngushëllimin.

Telegram ngushëllimi familjes Qorraj i ka dërguar edhe kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, i cili ka thënë se Isa Qorraj ka qenë burrë i besës dhe i fjalës. "Sot, si pasojë e një aksidenti trafiku të ndodhur ditë më parë, paska ikur në amshim punëtori i Ndërmarrjes Rajonale 'Drini i Bardhë' në Deçan, Isa Qorraj nga Carrabregu i Poshtëm. Isanë do ta kujtojmë gjithmonë si burrë të besës dhe fjalës, bashkëpunëtor i shkëlqyer, i përgjegjshëm dhe i përkushtuar për kryerjen e detyrave të punës. Ngushëllime familjes Qorraj dhe të afërmve! I lehtë i qoftë dheu!", ka shprehur ngushëllime Ramosaj.

Flet për "Epokën e re", Muharrem Nitaj

# Insistojmë në lidershipin e ShBA

Nënkryetari i AAK-së, Muharrem Nitaj, ka bërë me dije se kjo parti insiston jo vetëm në përfshirjen, por edhe në lidershipin e ShBA-së në dialogun Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se kritikat e tyre për këtë proces edhe në mënyrë të shkruar ia kanë paraqitur kryeministrit Avdullah Hoti. Ai ka deklaruar se ky proces duhet të jetë krejtësisht transparent dhe në çdo rrethanë pjesë e procesit duhet të jenë edhe përfaqësuesit e Aleancës. Sipas Nitajt, kritikat e kësaj partie për procesin e dialogut nuk duhet të shihen si konflikt ndërmjet partnerëve të koalicionit



EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 7 gusht** - Nënkryetari i AAK-së, Muharrem Nitaj, ka arsyetuar kritikat e kësaj partie për qasjen e kryeministrit ndaj dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka bërë me dije se lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, kritikat ia ka dorëzuar edhe në mënyrë të shkruar kryeministrit.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Nitaj ka thënë se AAK-ja synon jo vetëm përfshirjen amerikane në dialogun Kosovë - Serbi, por lidershipin e ShBA-së në këtë proces. "E para, ne insistojmë jo vetëm në përfshirjen, por edhe në lidershipin e ShBA-së në dialog. E dyta, procesi duhet të jetë krejtësisht transparent dhe në çdo rrethanë pjesëmarrës të këtij procesi duhet të jenë edhe përfaqësuesit e Aleancës, që është partnere dhe, së fundi, që dialogu të mos degradojë në çështje ordinere dhe teknike të cilat janë diskutuar e stërdiskutuar tash e sa vjet", ka thënë Nitaj. Ai ka deklaruar se kritikat e kësaj partie për procesin e dialogut nuk duhet të shihen si konflikt ndërmjet partnerëve të koalicionit. "Nuk besoj se kjo duhet të paraqitet si konflikt ndërmjet partnerëve në qeverinë e koalicionit, por si insistim për transparencë dhe llogaridhënie", është shprehur Nitaj.

Nënkryetari i AAK-së ka folur edhe për mocionin e Lëvizjes Vetëvendosje ndaj qeverisë Hoti. Ai ka vlerësuar se nuk e kanë marrë seriozisht këtë iniciativë të LV-së. "LV-ja si parti opozitare, këtë punë ka. Nuk është hera e parë që ajo ndërmerr nisma të tilla. Ju kujtohet edhe koha kur Ramush Haradinaj ka qenë kryeministër. Që në ditët e para pati filluar sagën e një mocioni të mundshëm kundër qeverisë. Unë besoj se ky përcaktim është doktrinar. Duket pak e panatyrshme kjo nismë në këtë kohë, por edhe e panatyrshme. Nisma e saj është krejtësisht legale. Nuk është se e kemi marrë seriozisht këtë punë dhe as që kemi diskutuar për të bile. Ajo po di, ajo le t'i grahë", ka thënë Nitaj.

Nitaj, i cili është zëvendësministër në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, ka deklaruar se qeveria po provon që t'i bëjë të gjitha ndryshimet e domosdoshme për menaxhimin e situatës së pandemisë. Ai ka deklaruar se qeveria po provon ta kthejë normalitetin në këtë drejtim, duke shprehur optimizëm se do të arrijë sukses.

**"Epoka e re":** *AAK-ja ka shprehur vlerësim kritik ndaj qeverisë. Pse?*

**Nitaj:** Ne jemi në një qeveri koalicioni dhe natyrisht mund të kemi edhe qëndrime edhe qasje të ndryshme për çështje të caktuara. I kemi bërë publike qëndrimet tona për disa çështje, që janë të përbashkëta, posaçërisht për procesin e dialogut. Në çështje nacionale siç është dialogu, debati duhet të jetë nacional dhe duhet të konsumohet me transparencë. Kryetari Ramush Haradinaj dhe Aleanca i kanë specifikuar 2-3 shqetësime që kanë të bëjnë

# FSK-ja shpall konkurs për pranimin e ushtarëve të rinj

Nga 10 gushti do të shpallet konkursi për pranimin e rekrutëve të rinj/ushtarë aktivë në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Formularët për aplikim mund të shkarkohen në uebfaqen e Ministrisë së Mbrojtjes. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka ftuar të rinjtë e Kosovës që të aplikojnë dhe të bëhen pjesë e ushtrisë për t'i shërbyer vendit



**Prishtinë, 7 gusht** - Ministria e Mbrojtjes ka bërë me dije se nga data 10 gusht do të shpallet konkursi për pranimin e rekrutëve të rinj/ushtarë aktivë në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Sipas njoftimit të kësaj ministrie, konkursi do të jetë i hapur deri më 21 gusht 2020. "Formularët për aplikim mund të shkarkohen në uebfaqen e Ministrisë së Mbrojtjes. Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht në të gjitha kazermat e FSK-së, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë kandidatët nga mosha 18-23 vjet", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.

Edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka ftuar të rinjtë e Kosovës që të aplikojnë në këtë konkurs. Në profilin e vet në "Facebook", presidenti ka shkruar se nuk ka mënyrë më të mirë për t'i shërbyer atdheut sesa duke iu bashkuar ushtrisë. "Bëhuni ushtarë të Republikës së Kosovës. Nuk ka mënyrë më të mirë për t'i shërbyer atdheut sesa duke iu bashkuar ushtrisë. Duke shërbyer në ushtri ju i shërbeni paqes, humanizmit, harmonisë, besimit në të mirën dhe e luftoni të keqen, jotolerancën dhe johumanen", ka shkruar presidenti Thaçi.

# A-së në dialogun Kosovë - Serbi



me këtë proces dhe ato ia kemi dërguar partnerit edhe të shkruara. E para, ne insistojmë jo vetëm në përfshirjen, por edhe në lidershipin e ShBA-së në dialog. E dyta, procesi duhet të jetë krejtësisht transparent dhe në çdo rrethanë pjesëmarrës të këtij procesi duhet të jenë edhe përfaqësuesit e Aleancës, që është partnere dhe, së fundi, që dialogu të mos degradojë në çështje ordinere e teknike, të cilat janë diskutuar e stërdiskutuar tash e sa vjet. Nuk besoj se kjo duhet të paraqitet si konflikt ndërmjet partnerëve në qeverinë e koalicionit, por si insistim për transparencë dhe llogaridhënie.

**"Epoka e re":** *Lëvizja Vetëvendosje ka iniciuar një mocion mosbesimi ndaj qeverisë Hoti. Cili është qëndrimi i AAK-së ndaj kësaj iniciative?*
**Nitaj:** LV-ja si parti opozitare, këtë punë ka. Nuk është hera e parë që ajo ndërmerr nisma të tilla. Ju kujtohet edhe koha kur Ramush Haradinaj ka qenë kryeministër. Që në ditët e para pati filluar sagën e një mocioni të mundshëm kundër qeverisë. Unë besoj se ky përcaktim është doktrinar. Duket pak e panatyrshme kjo nismë në këtë kohë, edhe e panatyrshme. Nisma e saj është krejtësisht legale. Nuk është se e kemi marrë seriozisht këtë punë dhe as që kemi diskutuar për të bile. Ajo po di, ajo le t'i grahë.

**"Epoka e re":** *AAK-ja ka hyrë në këtë qeveri me disa synime. A po i përmbush pritjet e AAK-së kjo qeveri?*
**Nitaj:** Qeveria ka funksionuar normalisht dhe i ka përmbushur detyrimet e veta. Ka funksionuar në rrethana të jashtëzakonshme edhe për shkak të pandemisë dhe krizës ekonomike të shkaktuar prej saj. Tani ne do të donim që të ishin kryer më herët plot veprime që e lehtësojnë jetën e qytetarëve në këtë kohë krize, por edhe kjo ka qenë e determinuar nga plot procese, siç është ai i riplanifikimit buxhetor dhe procesimi i të njëjtit e që është dashur të kalojë përmes Kuvendit e që kërkojnë kohë.

**"Epoka e re":** *Ndër prioritet kryesore të kësaj qeverie ka qenë rimëkëmbja ekonomike. Çfarë po bën qeveria në këtë drejtim?*
**Nitaj:** Së pari është pritur plotësim-ndryshimi i buxhetit dhe ky ka kaluar javën që shkoi. Tash është në proces miratimi i një sërë masash e ligjesh që do ta mundësojnë atë që po cilësohet rimëkëmbje ekonomike, e për disa mund të cilësohet edhe si mbijetesë. Sapo të përfundojë ky proces, do të ketë lehtësira edhe në pagesa për qytetarët, edhe për bizneset. E shoh që qeveria po provon që t'i bëjë të gjitha ndryshimet e domosdoshme që të menaxhohet situata e krijuar.

**"Epoka e re":** *Sa besoni se do të jetë e suksesshme qeveria në këtë drejtim?*
**Nitaj:** Pandemia ka shkaktuar krizë shumëdimensionale. Qeveria po provon që ta rikthejë njëfarë lloj normaliteti. Unë dua të besoj se do të ketë sukses.

# AGK-ja dhe ShSK-ja ndajnë maska dhe dezinfektues për gazetarë

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK), së bashku me Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës (ShSK), kanë nënshkruar kontratë bashkëpunimi me qëllim që t'u ndihmohet gazetarëve në Prishtinë, pasi që nga fillimi i pandemisë Komuna e Prishtinës është ballafaquar me numrin më të lartë të rasteve të të infektuarve me Covid 19.
AGK-ja ka thënë se në donacionin e siguruar nga ShSK-ja bëjnë pjesë 15 mijë maska, tre mijë dezinfektues, 100 ml dhe 300 dezinfektues një litër.
Kryetarja e AGK-së, Gentiana Begolli Pustina, e ka vlerësuar të një rëndësie të veçantë këtë ndihmë të ShSK-së për t'i mbrojtur gazetarët, të cilët, siç ka thënë ajo, edhe ashtu ballafaqohen me probleme të shumta, jo vetëm financiare. Sipas saj, mbrojtja e gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve kontribuon jo vetëm në mbrojtjen e shëndetit të tyre dhe funksionimin e medias, por edhe në informimin e saktë dhe në kohë reale te qytetarët e Republikës së Kosovës.
Ndërsa drejtori i ShSK-së, Sami Mazreku, ka shprehur përkushtim ta thellojë bashkëpunimin me AGK-në, me ç'rast ka theksuar gatishmërinë që AGK së bashku me ShSK-në të organizojnë trajnime vjetore për gazetarët që raportojnë për ekonomi dhe t'i shpërblejnë gazetarët e parvjetshëm me tri çmimet për storiet më të mira.
Sa i përket procedurës së shpërndarjes, AGK-ja ka theksuar se ka listat e gazetarëve që punojnë në terren dhe të cilët janë furnizuar me pako




mbrojtëse gjatë donacionit të parë. "Për tërheqjen e pakove të reja, të njëjtët do të njoftohen me kohë. AGK-ja njofton se do ta vazhdojë angazhimin për sigurimin e donacioneve të tjera në mënyrë që të ndihmohet komuniteti që përfaqësojmë dhe kolegëve tanë t'u lehtësohet sadopak puna përgjatë pandemisë", ka njoftuar AGK-ja.

# Haradinaj-Stublla: Kosova ka bërë koncesione të mjaftueshme me Pakon e Ahtisaarit



**Prishtinë, 7 gusht (ER)** - Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka zhvilluar një takim virtual me ministrin e Punëve të Jashtme të Finlandës, Pekka Olavi Haavisto. Me këtë rast, ajo ka shprehur mirënjohje për përkrahjen që shteti i Finlandës ka dhënë për integrimin evropian të Kosovës, veçanërisht për përkrahjen e vazhdueshme për lëvizjen e lirë në Zonën Shengen të qytetarëve të Kosovës. Në këtë takim është diskutuar edhe për dialogun Kosovë - Serbi, me ç'rast ministrja Haradinaj Stublla ka theksuar se shteti i Kosovës ka bërë koncesione të mjaftueshme me Pakon e Ahtisaarit dhe se tani është radha e Serbisë të angazhohet seriozisht për marrëveshje finale me njohje reciproke në kufijtë ekzistues.

# KFOR-i mbështet trajnimin profesional për gratë viktima të dhunës



**Deçan, 7 gusht** - Makineri profesionale të qepjes dhe mjete dhe pajisje të tjera të rrobaqepësisë janë dhuruar nga KFOR-i për Organizatën Joqeveritare (OJQ) "Jeta" me qendër në Deçan, për të mundësuar kurse të trajnimit profesional në favor të grave viktima të dhunës me bazë gjinore ose në gjendje të dëshpëruar.
Projekti është financuar nga NATO dhe është implementuar nga ushtarët italianë të KFOR-it nga Komanda Rajonale Perëndim, në kuadër të ndihmës së ofruar në mënyrë të paanshme për të gjitha komunitetet e Kosovës. "Jeta" është themeluar në vitin 2005 për t'i ndihmuar gratë në nevojë pa dallim etnie, moshe dhe feje, duke ofruar trajnime profesionale si kuzhiniere, parukiere dhe rrobaqepës. "Gjatë viteve shumë gra kanë përfituar nga aktivitetet e OJQ-ve dhe ne jemi mirënjohëse për përkrahjen e KFOR-it", ka thënë drejtoresha e OJQ-së "Jeta", Safete Gacaferi, e cila po avokon për promovimin e të drejtave dhe kushteve të grave në Kosovë.
Ndërsa kolonel Gianluca Figus, komandant i njësisë shumëkombëshe të KFOR-it, ka thënë se janë të përkushtuar që t'i përkrahin gratë të cilat janë viktima të dhunës. "Operacioni i udhëhequr nga NATO është i përkushtuar për t'i ndihmuar ato institucione dhe organizata që mbrojnë gratë dhe promovojnë rolin e tyre në Kosovë, në përputhje me frymën e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë", ka deklaruar Figus.
Në lidhje me këtë, javën e kaluar një ekip i ndërlidhjes dhe monitorimit i ushtrisë amerikane që i përkasin Komandës Rajonale të KFOR-it Lindje, i ofroi ndihmë strehës për gratë viktima të dhunës në familje "Shtëpia ime", të vendosura në Ferizaj.

# Osmani: Shtesat për policët, të domosdoshme

**Prishtinë, 7 gusht (ER)** - Kryetarja e Kuvendit e Kosovës, Vjosa Osmani, ka takuar të premten kryetaren e Sindikatës së Policisë së Kosovës, Valbona Kamberi, dhe kryetarin e rajonit të Gjilanit të kësaj sindikate, Ragip Ajeti, të cilët e kanë njoftuar kryeparlamentaren me sfidat me të cilat janë duke u ballafaquar policët gjatë pandemisë, duke përmendur orarin e tejzgjatur, moskompensimin e angazhimit në ndërrimin e natës si dhe orëve shtesë. Sipas tyre, shpërfillja e kategorisë së policëve nga qeveria përbën shqetësim dhe zhgënjim të kësaj kategorie.
Osmani ka theksuar se është e pafalshme që policët e Kosovës, të cilët me profesionalizmin e tyre kanë bërë që Policia e Kosovës tradicionalisht të cilësohet ndër institucionet më të besuara në vend, të trajtohet në mënyrë të padinjitetshme. Ajo ka pohuar se kontributi i Policisë së Kosovës në menaxhimin e pandemisë është i pazëvendësueshëm. Osmani ka thënë se institucionet e Kosovës duhet ta njohin kontributin e policëve duke i plotësuar kërkesat e tyre, të cilat ajo i ka cilësuar si minimale. Duke rikujtuar se ajo ka qenë e zëshme në artikulimin e kërkesave të policëve në Kuvend, sidomos të kërkesës për dhënie të shtesave gjatë pandemisë, Osmani e ka siguruar Sindikatën e Policisë së Kosovës se do të vazhdojë ta ngrehë zërin që policët ta marrin trajtimin e merituar nga Qeveria e Kosovës.



Rënie e lehtë e rasteve të reja me Covid në Republikën e Kosovës

# Tre të vdekur, 125 të shëruar dhe 181 raste të reja me virusin Korona

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit në vendin tonë kanë ndërruar jetë tre presona dhe janë paraqitur 121 raste të reja me Covid-19. Po ashtu, ky institut ka bërë me dije se janë shëruar edhe 125 persona të tjerë të cilët kanë që të prekur nga virusi Korona




EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 463 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 181 raste pozitive me Covid-19. Sipas këtij instituti, brenda kësaj periudhe kohore kanë vdekur tre presona dhe janë shëruar 125. "Numri total i rasteve pozitive është 9 869 raste nga 39 741 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 303 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 125 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 5 605 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 961", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtruar se Prishtina vazhdon të prijë me numrin e rasteve të reja me virusin Korona. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 87 raste, komuna Prizren 13 raste, komuna Podujevë 12 raste, komuna Gjilan 11 raste, komuna Lipjan 9 raste, komuna Drenas 8 raste, komuna Viti 8 raste, komuna Fushë Kosovë 7 raste, komuna Obiliq 6 raste, komuna Ferizaj 3 raste, komuna Rahovec 3 raste, komuna Suharekë 3 raste, komuna Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Dragash, Graçanicë, Han i Elezit, Klinë, Kllokot, Malishevë, Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri", ka njoftuar instituti që drejtohet nga Naser Ramadani.

Më tutje, IKShPK-ja ka përsëritur apelin bërë qytetarëve, duke kërkuar nga ta që t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19. "Të nderuar qytetarë, virusi është kudo. Ju lutemi përmbahuni rekomandimeve. Virusi vret! Zbatimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë duhet ta bëjë çdo qytetar i Republikës së Kosovës që të ruajë veten, të afërmit dhe të tjerët. Bartja e maskave mbetet obliguese. Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomia, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se vendi është duke shkuar drejt një normaliteti të ri. "Ky normalitet i ri paraqet ndërrimin e sjelljeve tona për të mirë, për ta mbajtur higjienën, për ta mbajtur distancën, për ta mbajtur maskën, për të mos përhapur piklat tona të cilat i qesim nga goja çdo ditë, dikush më shumë e dikush më pak, e që rrezikojnë shëndetin e të tjerëve, por në radhë të parë shëndetin e të afërmve, të familjes, të fëmijëve, të farefisit, të komunitetit, pastaj të të gjithë qytetarëve. Inspektoratet sanitare të AUV-it dhe inspektoratet komunale bashkë me shtabet komunale patjetër duhet ta zbatojnë Ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse duke u mbështetur në manualin për luftimin e Covid-19 dhe të merren masa përgjegjësie në çdo rast të moszbatimit eventual të rekomandimeve të Institutit Kombëtar", ka njoftuar ky institut. Sipas këtij instituti, çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve.

## Zemaj: 33 laboratorë privatë mund t'i nisin testimet për Covid nga java e ardhshme

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se 33 laboratorë privatë mund t'i nisin testimet për Covid-19 që nga java e ardhshme. Ai ka thënë se në ditët në vijim do të pajisen edhe me shtatë laboratorë që, sipas tij, do t'i rrisin kapacitetet për testime. "Nga 37 aplikacione, 33 i kanë plotësuar kushtet dhe mund të fillojnë me testime që nga java e ardhshme. Çdo ditë me kapacitetin e plotë IKShPK-ja është duke realizuar testime. Çdo ditë bëhen përafërsisht 500 testime. Në ditën në vijim ne do të pajisemi edhe me 7 laboratorë, 3 prej tyre janë siguruar nga OBSh-ja. Atëherë kapacitetet testuese do të jenë në nivel më të lartë", ka thënë Zemaj për "KK".




# S'ka më nevojë për pagesa në hyrje-daljet në QKUK

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Qytetarët e Kosovës nuk do të paguajnë më për hyrje-dalje në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Ky vendim është marrë të hënën nga ushtruesi i detyrë i drejtorit të përgjithshëm i Shërbimit Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK), Valbon Krasniqi, bazuar në situatën pandemike në vend dhe me qëllim të shmangies së kontakteve nëpër laura. "Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka vendosur që ta bëjë lirimin e të gjitha laurave në hyrje-daljet e Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës. Do të lejohen të gjitha automjetet e pacientëve dhe përcjellësve të pacientëve, pa pasur nevojë të bëjnë pagesa. Vendimin e ka marrë u. d. drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, duke u bazuar në situatën e krijuar në vend për shkak të pandemisë së Covid-19, me qëllim të parandalimit dhe shmangies së kontaktit nëpër laura", është thënë në njoftim. Sipas të njëjtit vendim, personeli i caktuar për punë në këto pika do të bartet sipas nevojës për kryerjen e punëve të tjera.

# OAK-u, kërkesa ndaj deputetëve për rimëkëmbjen e sektorit privat

**Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK), në kërkesën drejtuar deputetëve të Kosovës, përpos të tjerash, ka kërkuar që të bëhet subvencionimi i pagave për periudhën maj-shtator dhe subvencionimi i qirasë së paku deri më 30 shtator 2020. Po në kërkesën e kësaj ode është kërkuar që BQK-ja të bëjë ulje të normës së interesit në 1.7 për qind**



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 7 GUSHT- Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) për herë të dytë ka organizuar aksionin para Kuvendit të Kosovës dhe ka dorëzuar kërkesat e sektorit privat për deputetët e organit më të lartë përfaqësues të vendit tonë.

Koordinatorja në OAK, Qëndresa Ibrahimi, ka deklaruar se si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga pandemia, subvencionimi i bizneseve nga qeveria s'ka qenë në nivelin e duhur. Ajo ka thënë se OAK-u ua ka dorëzuar deputetëve propozimet e tyre që do ta ndihmonin rimëkëmbjen ekonomike. "Ne e dimë se si pasojë e pandemisë bizneset kanë pësuar dëme të mëdha dhe subvencionimi i shtetit, si pasojë e vështirësive që kanë hasur bizneset, deri më tani nuk ka qenë në nivelin e duhur. Ne i kemi dërguar propozimet tona për projektligjin e rimëkëmbjes ekonomike të cilat nuk janë inkorporuar në draftin final. Andaj jemi duke kërkuar që kërkesat e bizneseve të sektorit privat të përfshihen në pakon e rimëkëmbjes, me qëllim që të ndihmohen që ta ruajnë stabilitetin e tyre, të mos thellohet edhe më tepër kriza dhe të ruhen vendet e punës", ka thënë ajo.

Ndërsa zyrtarja e Odës së Afarizmit të Kosovës, Mirjeta Shala, ka deklaruar se në këto kërkesa përfshihet subvencionimi i pagave për periudhën maj-shtator, subvencionimi i qirasë së paku deri më 30 shtator 2020, si dhe ofrimi i kredive në periudhën dyvjeçare, dhe me afat pagese deri në 10 vjet, me garancinë e shtetit 80-100 për qind të shumës. Shala ka thënë se kanë kërkuar nga qeveria që të bëhet analizë dhe në bazë të saj të krijohet pakoja e rimëkëmbjes. "Duke pasur parasysh që kërkesat e odave nuk janë përfshirë në draftin final, ne si odë kemi kërkuar deri më tash nga qeveria që në pakon e rimëkëmbjes të parashihet një kompensim për stafin, në vlerë prej 220 eurove. Gjithashtu, kemi kërkuar që të subvencionohet qiraja në vlerë të 50 për qind të saj, të ofrohen kredi në periudha deri në dy vjet, me mundësi të kthimit deri në dy vjet, kjo pasi që bizneset kanë kërkuar që të kenë një ndihmë nga institucionet si rezultat i pakos së parë e cila është konsideruar më shumë si pako sociale. Ndër të tjera, kemi kërkuar që të bëhet analizë specifike për secilin sektor dhe të krijohet pakoja e rimëkëmbjes. Pra, shfrytëzojmë rastin t'i bëjmë thirrje qeverisë që t'i marr parasysh rekomandimet e bizneseve dhe të odave të cilat vazhdimisht kanë pasur takime në mënyrë që pakoja finale të dalë me nevojat konkrete të bizneseve", ka deklaruar ajo.

Pos të tjerash, në kërkesën e Odës së Afarizmit të Kosovës përfshihet financimi i faturave të energjisë elektrike për ndërmarrjet që gjatë kohës së pandemisë kanë qenë të prekura, për muajt prill-shtator 2020. Lirimi nga pagesa e tatimit në fitim, për kompanitë nga industritë që kanë pësuar dëme nga pandemia, për periudhën prill-shtator 2020. Gjithashtu të ofrohet përkrahje edhe për prodhuesit. Në kërkesë kërkohen të lirohen nga tatimet e të gjitha taksave për prodhuesit, duke përjashtuar TVSh-në, nga data 01 qershor deri më 31 dhjetor. Lirim i plotë i lëndës së parë për prodhues duke respektuar normativat dhe lënda e parë të lirohet sikurse kur blihet jashtë vendit, por dhe brenda vendit. Krijimi i një arke "Patrioti", ku çdo produkt vendor subvencionohet në dalje me 10 për qind ulje nga TVSh-ja. Krahas këtyre kërkesave, Oda e Afarizmit e Kosovës ka parashtruar kërkesa edhe për likuidet të kompanive, shtyrje të kësteve të kredive, ulje të normës së interesit të Bankës Qendrore deri në 1.7 për qind, ligji për përmbarim të pezullohet deri në fund të muajit shtator 2020, si dhe krijimi i një fondi për investime dhe zhvillim, përmes të cilit mund të realizohen të gjitha këto subvencione dhe përkrahje të bizneseve.

# Qeveria ndan 95.2 milionë për rimëkëmbjen ekonomike



PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Qeveria ka miratuar propozimin e Ministrisë së Financave për ndarjen e mjeteve financiare për rimëkëmbje ekonomike në shumë prej 44 700 152 eurove. Sipas njoftimit të qeverisë, mjetet e ndara kanë për qëllim të rimbursimit të shpenzimeve nga ekzekutimi i masave: nr. 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.7, 1.8, 1.14 dhe nr. 1.15, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 30 mars 2020 për aprovimin e Pakos Emergjente Fiskale.

Po ashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar propozimin e Ministrisë së Financave për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 50 500 000 eurove me qëllim të vazhdimit të ekzekutimit të masave: nr. 1.3, 1.7, 1.8, 1.14 dhe nr. 1.15, sipas vendimit nr. 01/19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Vendimet për ndarje të mjeteve me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga masat për rimëkëmbjen ekonomike të shkaktuar nga pasojat e pandemisë Covid-19 u morën në mbledhjen e sotme elektronike, të 21-në me radhë, të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me kërkesë të kryeministrit Avdullah Hoti.

## Hoti: Qeveria do ta mbështesë Telekomin e Kosovës

PRISHTINË, 7 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se qeveria do ta mbështesë Telekomin e Kosovës, pas krizës që e ka kapluar. Hoti ka zhvilluar një takim virtual me ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, të cilët janë pajtuar ta mbështesin këtë ndërmarrje publike. "Qeveria do ta mbështesë Telekomin e Kosovës. Me ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, zhvilluam sot një takim virtual me anëtarët e Bordit të Telekomit të Kosovës, me të cilët biseduam për gjendjen e përgjithshme në këtë ndërmarrje. Qeveria e Kosovës, si aksionar, do ta mbështesë këtë ndërmarrje publike me interes strategjik për vendin. Po ashtu, shumë shpejt do të diskutohet plani për rimëkëmbjen e Telekomit, i cili është duke u përgatitur nga bordi i kësaj ndërmarrjeje", ka shkruar Hoti në profilin e vet në "Facebook".



# Mustafa: Fondi i Sigurimeve do t'ua garantojë bujqve kulturat bujqësore

Ministri i Bujqësisë, Besian Mustafa, ka folur në Kuvendin e Kosovës për dëmet që janë shkaktuar ditët e fundit nga vërshimet, ku më së shumti ka pësuar zona e Dukagjinit. Ai ka bërë me dije se janë ndarë rreth dy milionë euro, apo 25 për qind e shumës së dëmeve të vlerësuara nga komisionet komunale



EPOKA E RE A.MAVRAJ

**Prishtinë, 7 gusht-** Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), Besian Mustafa, ka deklaruar se për zgjidhje afatgjatë, bujqit e Kosovës kanë nevojë për një fond për sigurime bujqësore, që u lejon atyre të merren me bujqësi e të mos shqetësohen për dëmet që shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore. Mustafa gjatë seancës plenare ka folur për dëmet që janë shkaktuar ditët e fundit nga vërshimet, ku më së shumti ka pësuar zona e Dukagjinit. Ai ka treguar se janë ndarë rreth 2 milionë euro, apo 25 për qind e shumës së dëmeve të vlerësuara nga komisionet komunale. "Sivjet kemi ndarë një buxhet prej 3.08 milionë eurosh për kompensimin e këtyre dëmeve, pra një fond të veçantë për kompensimin e këtyre dëmeve. Në gjashtëmujorin e parë kam kërkuar nga të gjitha komunat që t'i mbledhim të gjitha raportet nga komisionet komunale për evidentimin dhe vlerësimin e këtyre dëmeve. I kemi mbledhur të gjitha këto raporte nga 22 komuna dhe kemi nxjerrë vendim në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, ku kemi ndarë përafërsisht 2 milionë euro, apo 25 për qind të shumës së dëmeve të vlerësuara nga komisionet komunale", ka deklaruar ministri Mustafa.

Mustafa u ka bërë thirrje 22 komunave që t'i dorëzojnë listat që përmbajnë xhirollogaritë e fermerëve për kompensimin e dëmeve të tokave bujqësore të fermerëve. "Themelimi i fondit për sigurime bujqësore, që do të jetë një fond i veçantë. Së bashku me Ministrinë e Financave dhe të gjithë donatorët po hulumtojmë mekanizmat më të mirë që duhen ndërtuar për jetësimin e këtij fondi për sigurime bujqësore. Qëllimi ynë final është që të kemi një fond të mirëfilltë, i cili, së bashku me kompanitë e sigurimeve në Kosovë, do t'u garantojë bujqve të Kosovës siguri në kulturat e tyre bujqësore dhe të mos jenë më në mëshirë të fatit e të qeverisë qendrore komunale", ka thënë ai.

# Murtezaj: Qarkullimi financiar i bizneseve ka rënë për 833 milionë euro, shkak pandemia

Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka thënë se efektet negative të pandemisë janë edhe në qarkullimin financiar të bizneseve, ku 833 milionë euro ose 22 për qind ka rënie në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. "Si rezultat i rrethanave të krijuara pas 13 marsit kur u paraqiten rastet e para me Covid-19, ATK-ja ishte në mbështetje të plotë të qeverisë, bizneseve dhe punëtorëve", ka thënë ai




/Epoka e re/

**Prishtinë, 7 gusht-** Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka thënë se pjesa e parë e këtij viti ishte me shumë sfida si në fushën e shëndetësisë e, po ashtu, edhe në ekonomi. Ai ka thënë se të hyrat nga tatimet janar-qershor të këtij viti janë 215.9 milionë euro, ndërsa kontributet pensionale 83.1 milionë euro. Sipas tij, në këtë periudhë të pandemisë ka një rënie të të hyrave përreth 23 milionë euro. "Efektet negative të pandemisë janë edhe në qarkullimin financiar të bizneseve, ku 833 milionë euro ose 22 për qind ka rënie në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Si rezultat i rrethanave të krijuara pas 13 marsit, kur u paraqitën rastet e para me Covid-19, ATK ishte në mbështetje të plotë të qeverisë, bizneseve dhe punëtorëve", është shprehur Murtezaj. Sa i përket numrit të bizneseve të mbyllura dhe numrit të punëtorëve që kanë humbur vendet e punës në pandemi, drejtori Murtezaj ka thënë se ende nuk ka të dhëna zyrtare për këto statistika.

Ndërsa sa iu takon denoncimeve nga qytetarët për rritje të çmimeve nga bizneset në kohë pandemie, ATK-ja ka pranuar mbi 11 mijë denoncime, 4 000 prej tyre kanë vetëm për ngritje të çmimeve, për të cilat ky institucion ka marrë masa. Po ashtu, Murtezaj ka thënë se në këtë periudhë është bërë edhe parandalimi dhe luftimi i ekonomisë joformale. Me planifikim të buxhetit të rishikuar është paraparë që ATK-ja t'i inkasojë vetëm 2,5 për qind më pak me planin vjetor që, sipas Murtezajt, është dashur që parashikimi të jetë edhe më i ulët për shkak të aktivitetit të bizneseve në pandemi.

# Të hënën hapen çerdhet në Prishtinë

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, i cili ditë më parë ka thënë se nuk mund të hapen çerdhet në kryeqytet, sepse kjo ishte kompetencë e qeverisë, të premten ka bërë njoftuar se ekzekutivi ua ka deleguar kompetencat komunave për hapjen e tyre. Në këtë kontekst, ai ka thënë se çerdhet në kryeqytet do të hapen të hënën. "Vendimi i fundit i qeverisë e delegon kompetencën për hapjen e kopshteve te komunat. Komuna e Prishtinës i menaxhon 8 kopshte publike dhe 9 kopshte me bazë në komunitet, duke përfshirë SOS kopshtin. Këto kopshte do të hapen të hënën, më 10 gusht, duke zbatuar udhëzimin e hartuar nga MASh-i dhe protokollin e hartuar nga Komuna e Prishtinës në mënyrë që të mbrohet shëndeti i fëmijëve e punonjësve dhe të parandalohet përhapja e Covid-19", ka shkruar Ahmeti në "Facebook".



# Vazhdon pranimi i aplikacioneve të fermerëve për pagesa të subvencioneve në Kamenicë



KAMENICË, 7 GUSHT (ER) - Komuna e Kamenicës ka bërë me dije se nga 20 korriku në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) ka filluar aplikimi i fermerëve për pagesa direkte - subvencione për këtë vit. Sipas kësaj komune, kjo drejtori ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme që ky proces të rrjedhë sa më mirë dhe lehtë për fermerët e Kamenicës.

Drejtori i DBPZhR-së, Naim Arifi, ka thënë se stafi i kësaj drejtorie është duke ofruar angazhimin maksimal për pranimin e aplikacioneve nga fermerët tanë. "Angazhim maksimal i stafit për pranimin e aplikacioneve për subvencione - pagesa direkte për fermerët e komunës sonë. Edhe pse jemi në kohë pandemie dhe rreziku për shëndet është i vazhdueshëm, drejtoria jonë është duke punuar nga 10-12 orë në ditë, me një vullnet të madh, me të vetmin qëllim që të gjithë fermerët e komunës sonë të kenë mundësi për kryerjen e aplikimit për subvencione", ka thënë Arifi.

Aplikimet e fermerëve për pagesa direkte-subvencione pranohen deri më 14 gusht 2020.

# Drejtoria e Inspeksionit nis aksionin për zbatimin e masave dhe respektimin e distancës në lokalet e gastronomisë

MITROVICË, 7 GUSHT (ER) - Në kuadër të monitorimit të situatës së pandemisë në qytetin e Mitrovicës, Drejtoria e Inspeksionit ka vazhduar inspektimin e të gjitha lokaleve të gastronomisë për ta mbajtur nën kontroll zbatimin e plotë të rekomandimeve nga IKShPK-ja. Me këtë rast, inspektorët komunalë gjatë aksionit të sotëm kanë mbikëqyrur zbatimin e masave mbrojtëse si dhe respektimin e distancës fizike në lokalet e gastronomisë të cilat veprojnë në Mitrovicë.

Gjatë inspektimit, nga menaxherët e lokaleve është kërkuar respektimi i të gjitha masave mbrojtëse (maska) dhe distanca e duhur brenda lokaleve si masë preventive për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, me ç'rast në ato lokale ku nuk është respektuar masa janë vendosur shirita për krijimin e distancës mes tavolinave. Qëllimi i këtyre aksioneve është vetëdijesimi i qytetarëve për rrezikun nga pandemia dhe se respektimi i distancës dhe masat mbrojtëse janë vitale për ruajtjen e shëndetit. Andaj, Drejtoria e Inspeksionit bën të ditur se do t'i vazhdojë aksionet e tilla, me shpresë që kjo pandemi të kalojë sa më parë.




# 'Jetimat e Ballkanit' shpërndajnë 300 pako me mish në Malishevë

MALISHEVË, 7 GUSHT (ER) - Shoqata "Jetimat e Ballkanit" ka shpërndarë të premten 300 pako me mish për 300 familje në nevojë në Komunën e Malishevës. Shpërndarja e mishit është bërë përmes kryetarëve të fshatrave, për familjet në nevojë, për secilin fshat. Mishi i shpërndarë është i kurbanëve të dhuruar për shoqatën në fjalë. Me këtë rast, kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, e ka falënderuar Shoqatën "Jetimat e Ballkanit" për këtë shpërndarje, për familjet që kanë nevojë, sidomos në këtë kohë të krizës që jemi duke kaluar si pasojë e pandemisë. Shoqata "Jetimat e Ballkanit", e cila drejtohet nga humanisti Halil Kastrati, në vazhdimësi i ka përkrahur familjet në nevojë në Komunën e Malishevës.



# FONDI ‘VENDLINDJA THËRRET’, VLERË QË ËSHTË SHTRIRË NË SHBA DHE NË TË GJITHA VENDET E TJERA TË BOTËS KU KA SHQIPTARË (26)



Shkruan: Kudusi LAMA

Ndërsa për sa i përket fondit “Vendlindja Thërret”, mendoj se është një vlerë që është shtrirë edhe në ShBA e në të gjitha vendet e tjera të botës ku ka shqiptarë, pasi ishte një fond për financimin e luftës për ta shporrur pushtuesin. U vjen mirë ose jo serbëve, ai fond e ka kryer detyrën e tij shumë mirë si fond i luftës. Mënyrat se si kanë ardhur paratë te luftëtarët nuk ka shumë nevojë të merret në analizë, pasi me rëndësi ishte që luftëtarët të kishin mundësi ta kryenin detyrën e tyre në vijat e fronteve. Por ata që i grumbullonin këto para nuk ishin kriminelë e as ata që i jepnin. Të gjithë ishin shqiptarë që kishin dhembje për atdheun e robëruar dhe me mundin e tyre e me sakrifica dërgonin në frontet e luftës aq para sa kishin mundësi të kursenin duke mbajtur vetëm për ta përballuar jetesën e familjeve të tyre. Nderim për të gjithë ata që kanë kontribuar me gjak dhe me para për lirinë që gëzojmë. ShBA-ja e di vetë nëse janë ose jo kriminelë shqiptarët, pasi kanë bërë veprat e tyre në ShBA dhe janë vlerësuar prej sferave intelektuale dhe ligjore. Por ja që edhe atje Serbia i gjen të gjithë shqiptarët kriminelë, sepse kemi thënë edhe më lart, të gjithë ata që kanë investuar e luftuar kundër pushtuesit serbë dhe kolonizimit shekullor të Serbisë duke e nxjerrë atë përfundimisht jashtë Kosovës, janë kriminelë. Unë jam dakord që armiku le të na quajë edhe kriminelë, por nën pushtimin e tij të mos rrimë sepse, po e pranuam këtë për hir të asaj që të mos na quajnë kriminelë, ne do të ishim shuar si komb ose do të shuhemi. Qëndresa ndaj armikut nuk është krim, është lavdi.

“Krahas grumbullimit të parave, emigrantët shqiptarë në ShBA organizonin edhe porosi të ndihmës humanitare dhe armë, si dhe drejtimin e vullnetarëve, të cilët ishin përfshirë në repartet e UÇK-së në Kosovë - Metohi”.[1]

Është e vërtetë që nga ShBA-ja, përveç ndihmave në para, kanë ardhur edhe vullnetarë luftëtarë, të cilët, me luftën e tyre, sidomos me krijimin e batalionit “Atlantiku” në frontet e luftës në Kosovë i dhanë shumë lavdi Amerikës si qendër e demokracisë në botë, por edhe të gjithë shqiptarëve që aktualisht janë qytetarë të ShBA-së.

“Burimet informative amerikane paralajmëronin për mundësinë që në rajonin e Ballkanit shfaqet ‘sindromi kolumbian’, përkatësisht që mafia shqiptare bëhet mjaft e fuqishme dhe merr kontrollin në një ose më shumë zona në të cilat mbizotëron popullsia shqiptare. Në atë kohë është vërejtur se në planin politik një efekt i tillë tashmë është arritur me orientimin e profitit e fitimit të narko-terrorizmit të fituar në pushtetet vendore dhe në partitë politike. Atëherë Partia Demokratike sunduese e Shqipërisë është e dyshimtë se toleron e fiton nga tregtia e narkotikëve, si dhe t’i financojë partitë politike të gjymtuara dhe grupimet e tjera në Kosovë - Metohi e në Maqedoni. Për shkathtësinë në shfrytëzimin e parave ‘të pastruara’ të fituara nëpërmjet marrjes me narko-terrorizëm, kanë qenë të dyshimta edhe Partia maqedonase për Prosperitet Demokratik dhe partitë e tjera shqiptare në këtë shtet, sikurse dhe Partia Nacionale Demokratike ultranacionaliste, por edhe partitë shqiptare në Kosovë - Metohi. Paratë e fituara në mënyrë kriminale shpesh janë mbuluar nëpërmjet donacionit të emigrantëve. Fitimi nga narko-terrorizmi, i drejtuar në jug të Ballkanit në vitin 1993, arriti rreth një miliardë dollarë. Burime të njëjta kanë vërtetuar se, përveç blerjes së “mbrojtjes” mafioze këto para përdoren edhe për të fituar popullaritet në popull, nëpërmjet të ashtuquajturit patriotizëm por edhe për veprime të tjera kriminale, para së gjithash për blerjen e armëve. Në kontinentin evropian, shqiptarët e Kosovë - Metohisë mbajnë mbi 80 për qind të tregtisë së heroinës, degët e tyre gjenden së paku në gjysmën e vendeve evropiane; në muaj ata bëjnë kontrabandë 4 deri në 6 tonë heroinë, kurse vlera e kësaj droge në nivel vjetor arrin dy miliardë dollarë”.[2]

Duket se Serbia e kontrollon mjaft mirë rrjetin e narkotrafikut në Ballkan e në Evropë, pasi i di mirë të gjitha rrjetet e ndërtimit dhe të veprimit të saj. Dhe këtë e nxjerrë prej informacioneve amerikane, siç duket prej lidhjeve të ngushta që mund të ketë me rrjetet kriminale që shtrihen deri atje. Por në këtë paragraf të cituar tërheqin vëmendjen disa çështje që lënë hapësirë për të diskutuar: Së pari, në qoftë se burimet informative amerikane paralajmëronin për mundësinë që në rajonin e Ballkanit shfaqet “sindromi kolumbian”, përse



serbët ua veshin atë shqiptarëve? A nuk janë edhe serbët ballkanas e në Ballkan? A vetëm shqiptarët janë në Ballkan? Ky është një tregues, se sa hapur e ndërtojnë mashtrimin serbët. Sepse dihet që në Ballkan po të ketë rrjet narko-trafiku, nuk mund të veprojnë vetëm shqiptarët, nëse nuk bashkëpunojnë me serbët, me grekët, me bullgarët, me turqit etj. Shqiptarët në Ballkan jetojnë të rrethuar nga të gjitha këto shtete e kombe dhe nuk mund të ketë rrugë trafiku për të ndërtuar “sindromin kolumbian” vetëm me shqiptarët, sepse megjithëse ka momente që edhe në Shqipëri janë parë parcela të mbjella me hashash, ato nuk mund të kenë fuqinë e krijimit të atij rrjeti që pretendojnë serbët. Prandaj, para se t’u venë emrin shqiptarëve si narkotrafikantë, le të thonë edhe që rrugët e drogës për në Shqipëri kalojnë pasi flenë një natë në Beograd, në Athinë, në Sofje, në Stamboll, në Podgoricë etj.

Së dyti, Në ato vite për të cilat flitet në këtë paragraf thuhet se “është vërejtur se në planin politik një efekt i tillë tashmë është arritur me orientimin e profitit e fitimit të narko-terrorizmit të fituar në pushtetet vendore dhe në partitë politike. Atëherë Partia Demokratike sunduese e Shqipërisë është e dyshimtë se toleron e fiton nga tregtia e narkotikëve, si dhe të financojë partitë politike të gjymtuara dhe grupimet e tjera në Kosovë - Metohi e në Maqedoni”. Nuk e kuptoj sa guxim kanë serbët që të akuzojnë një shtet, si Shqipëria si qendër të narkotrafikut. Por unë po habitem se si paska financuar edhe partitë në Kosovë e në Maqedoni dhe për këtë ju akuzoni UÇK-në që në atë kohë nuk ishte deklaruar akoma si strukturë unike vepruese. Akoma vepronin grupe të pa unifikuara ushtarakisht, ishin vetëm të unifikuara politikisht nëpërmjet lëvizjes politike “Lëvizja Popullore e Kosovës”. Për shkathtësinë në shfrytëzimin e parave “të pastruara” të fituara nëpërmjet marrjes me narko-terrorizëm, kanë qenë të dyshimta edhe Partia maqedonase për Prosperitet Demokratik dhe partitë e tjera shqiptare në këtë shtet, sikurse dhe Partia Nacionale Demokratike ultranacionaliste, por edhe partitë Shqiptare në Kosovë - Metohi”. Dhe ajo që është për të tërhequr vëmendjen, asnjë nga ato parti në Kosovë e në Maqedoni që i paska financuar Partia Demokratike e Shqipërisë nuk janë bërë përkrahëse të luftës së UÇK-së, bile as vetë Partia Demokratike e Shqipërisë. Pra, si e justifikojnë serbët këtë akuzë? Apo edhe kjo akuzë është si për gjithë rrjedhën e akuzave që të gjithë shqiptarët janë kriminelë. Mirë është në fakt që bëhet edhe kjo akuzë, pasi të paktën u hiqet e drejta atyre që nuk kanë qenë pjesë e UÇK-së, që të vazhdojnë t’u bëjnë propagandë këtyre shpifjeve, pasi në mjaft raste ka pasur edhe prej tyre që edhe pa i cituar u janë adresuar në debatet politike dhe mediatike.

Së treti, në citimin e mësipërm thuhet se këto parti një pjesë të parave vërtetë të shumta jo me miliona por me miliarda dollarë, i paskan përdorur për të blerë armë. Nuk di për çfarë i paskan përdorur këto armë, pasi realisht Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk ia kanë dhënë. Meqë e dinë serbët këtë të vërtetë është mirë të na thonë ku kanë shkuar këto armë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës armët në Kosovë i ka futur duke i mbartur në shpinë, dhe qenkan treguar shumë të paaftë pasi paskan pasur mundësinë të blejnë edhe ushtrinë e policinë serbe,sepse paskan pasur gjithë ato para.

Së katërti, duke deklaruar se në “kontinentin evropian, shqiptarët e Kosovë – Metohisë mbajnë mbi 80 për qind të tregtisë së heroinës, degët e tyre gjenden së paku në gjysmën e vendeve evropiane; në muaj ata bëjnë kontrabandë 4 deri në 6 ton heroinë, kurse vlera e kësaj droge në nivel vjetor arrin dy miliardë dollarë”, po shihet se kjo luftë paska qenë shumë e lehtë për t’u kryer. Nuk kuptoj pse atëherë luftëtarët kanë pasur mjaft probleme për sigurimin e armëve e të mjeteve të nevojshme për luftë deri edhe për ushqime. Mirë është që përveç evidencës së fitimeve të ishin dhënë edhe rrugët e shpenzimeve të këtyre parave. Dhe të mos harrojmë se në këtë rast nuk flitet për vitet 1997 - 1999, por për disa vite më herët, praktikisht për vitin 1993, kur në Shqipëri sapo kishte marrë pushtetin demokracia e dalë nga zgjedhjet e vitit 1992.

“Fitimet e grupeve narkotike shqiptare arrijnë një miliard dollarë amerikan, ku qarkullimi në Kosovë - Metohi sjell nga 125 deri 150 milion dollar, nga të cilët 25 milion i shkojnë K3K. Hashim Thaçi, si pjesë të vetën, fiton 5 milion dollarë amerikan”.[3] Dhe menjëherë përsëri akuza përqendrohet tek Hashim Thaçi i cili fiton jo pak, por plot 5 milionë dollarë në vit, kurse UÇK-ja deri 150 milionë. Ah sikur vërtetë të kishte UÇK-ja 150 milionë dollarë gjatë luftës, sa gjëra do të kishin shkuar plotësisht ndryshe. Dhe jam i sigurt se këtë e di edhe Serbia me gjithë Dick Martyn, por u intereson ta ndërtojnë frazeologjinë në mënyrë të tillë. Me rëndësi është të jepen shifra që të bëjnë përshtypje tek lexuesit, nuk ka rëndësi sa të vërteta janë ato. “Shqiptarët kanë themeluar një nga organizatat më të mëdha për kontrabandën në Evropë ndërsa fitimi i arritur me tregtinë ilegale “pastrohet“ nëpër 200 banka private”.[4] Ja edhe një shifër tjetër, që nëse do të kishin gjithë këto të ardhura shqiptarët do ta kishin blerë edhe Serbinë e do t’i kishin nxjerrë serbët të silleshin rrugëve të botës. “Krahas tregtisë së drogës, kriminelët shqiptarë merren edhe me prostitucion, me reketim, me tregtinë e përhapur gjerësisht të armëve, si dhe me organizimin e lypjes dhe të vjedhjes së xhepave në të cilën, me anë të keqpërdorimit dhe keqtrajtimit të vazhdueshëm, kanë angazhuar fëmijët e blerë nga familjet në Shqipëri, me një çmim prej 1 000 dollarë për fëmijë”.[5] *(Vijon)*

---

1 Po aty faqe 39

2 Obiliç, Millosh, “Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare”, “dosjet sekrete”, Beograd, 2004, faqe 39 – 40, botimi serbisht

3 Obiliç, Millosh, “Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare”, “dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 40, botimi serbisht

4 Po aty faqe 41

5 Po aty faqe 41

E jashtëzakonshme

# Notarja bën not me një gotë plot me qumësht në kokë



Notarja me famë botërore, Katie Ledecky, vitet e fundit ka qenë kampione absolute në garat me not. Këtë ajo e ka dëshmuar edhe me anë të një video të publikuar në aplikacionin "TikTok", ku ka shpalosur të gjithë talentin e saj. Katie është shfaqur duke bërë not, ndërsa mbi kokë mbante një gotë lëng. Me gotën mbi kokë kampiona olimpike ka përshkruar të gjithë pishinën 50 metra të gjatë. Ajo që bie në sy është fakti se si ajo ka arritur ta mbajë ekuilibrin dhe ta kalojë me sukses këtë sfidë. "Ndoshta një nga gjërat më të mira të karrierës sime", ka shkruar Katie, duke publikuar edhe një video.

## BARSOLETA E DITËS

E dashura: Shpirt, më duket vetja shumë e shëndoshë, e shëmtuar dhe e plakur.
I dashuri: Edhe?
E dashura: Të lutem ma bëj një kompliment.
I dashuri: Zemër, ke shikim shumë të mirë.

KINO ABC PRISHTINE

**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**

FOTO E DITES



Breshëri që ka rënë gjatë kësaj jave ka shkaktuar dëme të kulturave bujqësore në Komunën e Istogut



E rrallë

# Studimi: Për t'i ruajtur të gjitha kujtimet, duhet të flemë

Gjumi luan një rol të rëndësishëm në shëndetin tonë. Truri është shumë i zënë kur flemë, duke përsëritur ato që kemi mësuar gjatë ditës. Gjumi ndihmon në riorganizimin e kujtimeve dhe i paraqet ato në mënyrën më efikase. Një studim i ri tregon se si gjumi konsolidon kujtimet e krijuara rishtas dhe parandalon dëmtimin e kujtimeve të vjetra.

Autori kryesor i studimit, Maksim Bazhenov, ka thënë: "Gjetjet tona sugjerojnë që kujtimet janë dinamike, jo statike. Me fjalë të tjera, kujtimet, madje edhe kujtimet e vjetra, nuk janë përfundimtare. Gjumi vazhdimisht i azhornon ato. Ne parashikojmë që gjatë gjumit kujtimet e vjetra dhe ato të reja rishikohen spontanisht, gjë që parandalon harrimin dhe rrit performancën e kujtimeve". Bazhenovi ka theksuar se përsëritja e kujtimeve gjatë gjumit luan një rol mbrojtës kundër harresës. "Ne mësojmë shumë gjëra të reja çdo ditë dhe ato kujtime konkurrojnë me kujtimet e vjetra. Për të ruajtur të gjitha kujtimet, duhet të flemë", është shprehur ai.



**DASHI** Mundësi të mrekullueshme për ata që kërkojnë partnerin e ëndrrave të tyre. Dashuritë e papritura mund të lindin edhe në vendin e punës.



**DEMI** Udhëtime dhe miqësi të shkurtra në krye të vëmendjes. Nuk do të jetë një ditë aspak e mërzitshme.



**BINJAKËT** Ju jeni në gjendje ta rrëmbeni simpatinë e njerëzve me të cilët jeni të lidhur nga respekti dhe dashuria.



**LUANI** Ju mund të tërhiqeni fort nga dikush që është simpatik dhe ka një ndjeshmëri të veçantë.



**VIRGJËRESHA** Ju do të keni humor për të zgjidhur çdo lloj shqetësimi. Ju keni frymëzime origjinale dhe forcë vendimmarrëse.



**PESHORJA** Dialogu është tërheqës dhe i thellë, fjalët tuaja dëgjohen me kënaqësi dhe janë përbërësi kryesor i marrëdhënies me partnerin tuaj.



**AKREPI** Perspektiva të shkëlqyera për ata që dëshirojnë të konsolidojnë lidhjen emocionale, për ata që kërkojnë një vendbanim përfundimtar.



**SHIGJETARI** Gjallëria e ideve është e kombinuar me aftësi të shkëlqyera kritike dhe mprehtësi shprehëse.



**SHIGJETARI** Konsolidimi i lehtë i pozicioneve profesionale dhe një miqësi për të cilën ju intereson. Sigurohuni që një anëtar i familjes në vështirësi ta ketë të gjithë ndihmën e nevojshme.



**BRICJAPI** Do të jetë një ditë e shkëlqyer për ju. Do të keni reflekse të mira për të bërë diçka të rëndësishme.



**UJORI** Ju jeni dëshmitar i një miqësie të konsiderueshme dhe të fortë. Kjo do të jetë një ditë shumë dinamike dhe me plot nisma.



**PESHQIT** Është periudha ideale për të formuar diçka që është fryt i krijimtarisë suaj, për t'i dhënë një gjurmë të re historisë suaj të dashurisë.

# Nora Istrefi nis ditën në palestër, tregon linjat e përkryera






Nora Istrefi, edhe pse është nënë, vazhdon të ketë një formë mbresëlënëse. Ajo së fundmi në profilin e vet në "Instagram" ka postuar një foto ku shfaqet në formë të mirë fizike teksa kryen ushtrimet në palestër. 35-vjeçarja në shumicën e rasteve ka theksuar se i kushton vëmendje dukjes dhe formësimit të trupit. Kjo ka bërë që këngëtarja shqiptare të komentohet në masë të madhe, ndërsa edhe ka grumbulluar një numër të konsiderueshëm fansash.



# Rita Ora, e veshur vetëm me mister

Këngëtarja shqiptare ka paralajmëruar projekte të reja në muzikë. Ajo ka ditur gjithmonë të luajë me asetet e saj fizike dhe feminilitetin. E talentuar, por edhe seksi, performuese dhe lozonjare. Rita Ora ka shfaqur të gjitha dimensionet e saj në këtë foto provokuese. Pozat e fundit tregojnë se di ta ruajë mirë balancën dhe kufirin e hollë që e ndan të bukurën me vulgaren. Ujë e sapun, përkëdhelur nga dielli, Rita i ka dhënë natyrës versionin me origjinal të saj.

# Rozana Radi ua mbyll gojën atyre që e kritikuan për mbipeshë




Rozana Radi ka ndarë një mesazh kuptimplotë pas kritikave nga ndjekësit. Pasi është kritikuar shumë për mbipeshë, Rozana Radi ua ka kthyer ndjekësve se kjo nuk e bën atë më pak inteligjente apo më pak të bukur. Këngëtarja shumë e dashur për publikun, ka ndarë një foto buzë detit ku shfaqet me bikini, duke demantuar të gjithë për çështjen e mbipeshës. "Unë jam tipi i gruas që më kënaq një pendim. Unë jam tipi i gruas që qaj me një film. Nuk më impresionojnë muskujt te një burrë, edhe pse i vlerësoj ata që merren me sport. Preferoj të dëgjoj nga një burrë që bisedat me mua janë ato që i pëlqejnë më shumë tek unë. Mënyra se si qesh, se si surprizohem. Një kg më shumë në trup nuk më bën më pak të lexuar", ka shkruar Rozana në llogarinë e vet në "Facebook".

# Modeluesja e bëshme shfaqet nudo në shtrat



Modeluesja Ashley Graham është mjaft aktive në rrjete sociale dhe shpesh ndan me fansat foto nga përditshmëria e saj. 32-vjeçarja para disa muajsh lindi një djalë dhe "Instagramin" e saj pas lindjes, e ktheu në një "auditor online' duke dhënë këshilla për nënat e reja. Por me foton e fundit që ka postuar në këtë rrjet, modeluesja e bëshme i ka lënë pa fjalë të gjithë. Ajo është shfaqur tërësisht nudo dhe përbri saj ka edhe të birin, të cilit gjithashtu nuk i ka veshur rroba. Ajo e ka pozuar këtë format fotoje për një revistë të njohur, bëjnë me dije mediat e huaja. Poza në fjalë ka marrë miliona pëlqime dhe mijëra komente.




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Krasniqi ndahet me Ballkanin, arrin marrëveshje me Prishtinën

Besnik Krasniqi është ndarë të premten me skuadrën e Ballkanit, kurse karrierën e futbollit do ta vazhdojë në skuadrën e Prishtinës. Krasniqi ishte pjesë e klubit kryeqytetas para se të transferohet në Shqipëri

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 GUSHT - Mbrojtësi i njohur Besnik Krasniqi është larguar nga skuadra e Ballkanit. Largimin nga skuadra suharekase, Krasniqi e ka konfirmuar nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Facebook". "Nuk jam më pjesë e Ballkanit! Kemi rënë dakord që të ndërpresim bashkëpunimin për arsye personale. Klubit ku kalova dy vjet të mrekullueshme, i dëshiroj suksese të mëtutjeshme. E falënderoj përzemërsisht presidentin Arsim Kabashi, trajnerin Ismet Munishi dhe gjithë kryesinë dhe shtabin teknik si dhe tifozët e mrekullueshëm 'Xhebrailat'", ka shkruar Krasniqi.
Gazeta nga burime të afërta me futbollistin ka marrë vesh se ai do të rikthehet pas shumë vitesh në skuadrën e Prishtinës. "Krasniqi ka qenë që një kohë në bisedime dhe marrëveshja është arritur. Shumë shpejt do të bëhet edhe zyrtarizimi", ka thënë burimi në fjalë.
Besnik Krasniqi që shumë vite është një nga lojtarët më të mirë në futbollin e Kosovës. Përveç Ballkanit dhe Prishtinës, ai ka luajtur edhe për Istogun, Llapin dhe Feronikelin në Kosovë, kurse në Shqipëri ka luajtur për Teutën e Durrësit dhe Partizanin e Tiranës. Ndërsa skuadra e Llapit ka arritur ta transferojë mbrojtësin e njohur



Bajram Jashanicën, i cili ka qenë pjesë e përfaqësues së Kosovës në futboll. "Kemi kënaqësinë t'jua prezantojmë futbollistin Bajram Jashanica, i cili së fundmi ka mbrojtur ngjyrat e Klubit KF Skënderbeu (Korçë), ku ka bërë karrierën më të gjatë të tij si superlojtar, po ashtu Jashanica ishte dhe reprezentues i përfaqësueses së Kosovës 2016-2017", thuhet në një njoftim të Ballkanit.
Në sezonin e fundit, 29-vjeçari pati 11 paraqitje për Skënderbeun.
Jashanica në 2018-n ishte dënuar me dy vjet moslojë për shkak të dopingut.

### Maliqi largohet nga Llapi

Mesfushori Behar Maliqi nuk është më pjesë e Llapit. Vetë mesfushori ka publikuar lajmin përmes një postimi në "Facebook", ku ka falënderuar kryesinë e klubit dhe bashkëlojtarët. 33-vjeçari ishte pjesë e Llapit në dy sezonet e fundit, pastaj ka kaluar nga Feronikeli. "Nga sot nuk do të jem më pjesë e Klubit KF Llapi. Falënderoj kryesinë, të gjithë trajnerët dhe bashkëlojtarët. Një falënderim i veçantë shkon për tifozët e KF Llapit, për mbështetjen e dhënë gjatë kësaj kohe", ka shkruar Maliqi në profilin e vet në "Facebook".

### Kaçiu prezantohet tek Arbëria

Portieri Donat Kaçiu është prezantuar te klubi i inkuadruar në Superligë, Arbëria nga Dobraja. "KF Arbëria blindon portën me ardhjen e portierit Kaçiu. Kaçiu ishte pjesë e skuadrës së Gjilanit dhe, së fundmi, përfaqësonte skuadrën Ferizajt. Kryesia KF Arbëria ka mirëpritur transferimin e portierit Kaçiu. Ata së bashku u pajtuan për suksese dhe për arritjen e objektivave", thuhet në njoftimin e Arbërisë.

# Kelmendi: Medaljes Olimpike iu gëzuan të gjithë shqiptarët

PRISHTINË, 7 GUSHT - 7 gushti 2016 do të mbetet një nga datat që do të hyjë në librat sportivë jo vetëm në Kosovë. Një vend i vogël, pas vetëm dy ditësh debutimi në ngjarjen më të madhe sportive në botë, Lojërat Olimpike, ia doli ta fitojë medaljen e artë.
Xhudistja Majlinda Kelmendi bëri miliona shqiptarë krenarë, kur fitoi një nga një luftërat në kategorinë deri në 52 kilogramë, për t'u ngjitur më pas në majën e podiumit të Lojërave Olimpike "Rio 2016". Krahas medaljes, flamuri ynë valoi më së larti, duke e përfshirë Kosovën në hartën e shteteve me medaljen olimpike. Katër vjet më pas, Majlinda



vazhdon të mos ndalet dhe ndihet e uritur për suksesin tjetër madhështor, medaljen e dytë olimpike. Ajo po përgatitet për Lojërat Olimpike Tokio 2020, të shtyra për një vit shkaku i pandemisë Covid-19. Ky përvjetor e gjen Majlindën bashkë me trajnerin e saj, arkitektin e këtij suksesi, Driton Kuka, në Turqi, ku po marrin pjesë në kampin përgatitor me kombëtaren e Turqisë. Kampionia Olimpike në intervistën dhënë Komitetit Olimpik të Kosovës, kujton me krenari 7 gushtin e 2016-s.

*Këtë herë ky përvjetor po ju gjen në Turqi në kamp përgatitor. Si po ndiheni sot në katër vjet me medalje të artë?*
**Kelmendi:** Sa më shumë kohë që po kalon aq më e pabesueshme po më duket medalja e artë olimpike. Jam shumë e lumtur dhe krenare njëkohësisht.

*A keni marrë sot urime për këtë përvjetor dhe a ju ka uruar edhe ndonjë xhudiste ose personalitet i lartë në Kosovë ose jashtë vendit?*
**Kelmendi:** Kam marrë mjaft urime sot dhe mendoj që medaljes olimpike iu kanë gëzuar të gjithë shqiptarët kudo që janë.

*Si ndiheni kur i shihni videot e finales apo të pranimit të medaljes, si dhe a i shikoni ende luftërat deri në finale?*
**Kelmendi:** Kohë pas kohe i shikoj luftërat, dhe sa herë që i shoh më emocionojnë shumë. Kujtimi është ende shumë i freskët.

*Cilin moment e kujtoni më së shumti nga 7 gushti 2016? Finalen, ceremoninë e medaljeve, ngritjen e flamurit apo...?*
**Kelmendi:** Që të gjitha këto që i përmendët e kanë pasur domethënien e vet. Secili kujtim është më i bukur se tjetri.

*Çfarë ka ndryshuar te Majlinda prej fitimit të medaljes së artë olimpike?*
**Kelmendi:** Realisht asgjë, sepse vazhdoj me qenë Majlinda e njëjtë qysh kam qenë gjithmonë.

*7 gushtin 2021 do ta festosh vetëm me medaljen e Rios, apo edhe me ndonjë medalje nga "Tokio 2020"?*
**Kelmendi:** Besoj shumë që prej Tokios do të kthehem me medalje.

## Shtatë të infektuar me Covid-19 në FC Prishtina

PRISHTINË, 7 GUSHT - FC Prishtina nëpërmjet një njoftimi ka bërë me dije se nga testet për Covid-19 pozitivë kanë rezultuar tre lojtarë dhe katër anëtarë të stafit. "FC Prishtina mbrëmë ka pranuar rezultatin e testeve nga IKShPK-ja dhe prej 34 të testuarve, pozitivë kanë dalë shtatë sosh, tre futbollistë, një prej tyre 17 vjeç dhe katër anëtarë të stafit të ekipit. FC Prishtina e priste një rezultat të tillë dhe ky testim i duhej që skuadra të ishte sa më e sigurt para ndeshjeve të Evropës. Të gjithë të infektuarit nuk kanë simptoma të theksuara dhe nuk kanë udhëtuar me skuadrën në Istog ku sot në mëngjes mbajti seancën e parë stërvitore. Të infektuarit pritet të ritestohen sërish pas pak ditësh, sepse konsiderohet që të gjithë janë në fund të procesit të infektimit dhe afër shërimit të plotë", thuhet në njoftimin e FC Prishtina.
Skuadra fituese e Kupës do t'i vazhdojë përgatitjet në fushën e Istogut deri më 17-18 gusht, derisa kundërshtarin në ndeshjen paraeliminatore e mëson më 9 gusht, kurse ndeshjen e zhvillon më 20 gusht, varësisht shortit.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Burim Veliu” B.I Slivovë, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Slivovë, Prishtinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 31.08.2020 në ora 10:30 në hapësirat e restorant “California” në Prishtinë do të organizohet debat publik nga kompania “Burim Veliu” B.I Slivovë, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Slivovë, Prishtinë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM
https://us04web.zoom.us/j/2801512624?pwd=aWE5OXNlL3RvU0lPZUdURTRMd1JPQT09

Meeting ID: 280 151 2624
Passcode: 059214

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Uniteti

Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti”
Sh.A Mitrovicë

---

## NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.A – Mitrovicë, zgjat afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarik për aplikimin të kandidatëve për pozitën:

- Faturist/e ( 1) – Konkursi i shpallur me datë 23.07.2020 në të përditshmen “Epoka e Re”.

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve, afati i konkursit vazhdohet prej datës 08.08.2020 deri më 14.08.2020.

**Vërejtje**: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në Zyren e Arkivës në K.R.M “Uniteti” Sh.A - Mitrovicë

An EU Funded Project
Managed by the EU Office in Kosovo

HIT FLORES
organic herbs & fruits from Shari Mountains
Implemented by Hit Flores ShPK

## Contract Title: Supply and Installation of 100 kW of Solar Panels

## Publication Reference: 1-2019/413-249

05 August 2020

Hit Flores Sh.P.K, with the address: Sheshi i Deshmoreve, Dragash, 22000, Kosovo, intends to award the contract for: **Supply and Installation of 100 kW of Solar Panels**.

All interested and qualified bidders, national and international, are invited to apply. The tender dossier is available from hit_flores@hotmail.com

The deadline for submission of bids is: 05 September 2020 at 15:00 hours local time at the following address: Hit Flores Sh.P.K, Sheshi i Deshmoreve, Dragash, 22000, Kosovo.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ “Krasniqi” Sh.P.K shpall të pavlefshme certifikatën e regjistrimit: 70917890

▶ Sherif Ademi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Ibrahim Fehmiu " Arbane

▶ Rushadije Ajazaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Dëshmorët e Zhurit " Zhur

▶ Aida Alija shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Ekrem Rexha " Lubizhd

▶ "3A ELEKTROSERVISI" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 601541958.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L